



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/-L-011

PËR ORGANIZIMIN SINDIKAL NË KOSOVË

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton:

LIGJ PËR ORGANIZIMIN SINDIKAL NË KOSOVË

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë dhe të përcaktojë të drejtat dhe liritë e të punësuarëve për themelimin dhe organizimin e lirë dhe vullnetar në organizata sindikale në sektorin publik dhe privat, me qëllim të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të punëtorëve nga puna dhe marrëdhënia e punës.

2. Me këtë ligj nuk rregullohen të drejtat dhe liritë për veprim dhe organizim sindikal në Forcën e Sigurisë së Kosovës, dhe shërbime të tjera të përcaktuara me ligj të veçantë.

Neni 2
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Sindikatat** - organizata të pavarura, që krijohen si bashkim vullnetar të të punësuarve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave ligjore dhe interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të anëtarëve të tyre;

1.2. **Organizatë sindikale** - çdo organizatë e të punësuarëve e krijuar në formë të shoqatës apo njësisë organizative të federatës, konfederatës, e cila ka për qëllim të përfaqësojë dhe mbrojë interesat e punëtorëve të bashkuar në organizata sindikale;

1.3. **Organizata e punëdhënësve** – organizata në të cilën punëdhënësit bashkohen në bazë të vullnetit të lirë për mbrojtjen e interesave të tyre;

1.4. **Liria sindikale** - e drejta civile e të punësuarëve që të krijojnë dhe të bashkojnë organizata sindikale të cilat i organizojnë lirshëm aktivitetet, administrimin dhe veprimtarinë sindikale për të mbrojtur interesat e tyre;

1.5. **Statuti i sindikatës** - akti më i lartë juridik i sindikatës, me të cilin rregullohet dhe përcaktohet fushëveprimi, parimet themelore të punës, organizimi sindikal, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve, si dhe përbërja dhe funksionimi i organeve drejtuese sindikale;

1.6. **Shoqata sindikale** - organizata themelore sindikale e të punësuarëve të anëtarësuar vullnetarisht, e cila ka për qëllim mbrojtjen e interesave të punëtorëve të një subjekti juridik;

1.7. **Federata sindikale** - organizata sindikale e përbërë prej shoqatave sindikale të anëtarësuar vullnetarisht, e cila ka për qëllim mbrojtjen e interesave të grupacionit të caktuar të punëtorëve;

1.8. **Konfederata sindikale** - organizata sindikale e bashkimit vullnetar të federatave sindikale me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së interesave të anëtarëve sindikal;

1.9. **MPMS** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS);

1.10. **ONP** - Organizata Ndërkombëtare e Punës;

1.11. **KNS** - Konfederatat Ndërkombëtare të Sindikatave;

1.12. **KSE** - Konfederatat e Sindikatave Evropiane;

1.13. **Sindikata përfaqësuese** - organizata sindikale me numër më të madh të anëtarëve të punësuar e nivelit përkatës .

Neni 3

E drejta për bashkim

1. Të punësuarit kanë të drejtë sipas vullnetit të tyre të themelojnë organizata sindikale dhe të anëtarësohen dhe bashkohen në to, sipas këtij ligji, Statutit Sindikal dhe standardeve ndërkombëtare sindikale dhe Konventave Ndërkombëtare të ONP-së.
2. Të punësuarit kanë të drejtë sipas vullnetit të tyre të formojnë organizata sindikale dhe të bashkohen në federata dhe konfederata sipas kushteve dhe parimeve të përcaktuara në aktet e organizatës sindikale;
3. Organizatat sindikale sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni mund të themelohen pa kurrfarë pëlqimi nga autoritetet qeveritare dhe punëdhënësit.

Neni 4

E drejta për anëtarësim në organizatë sindikale

1. I punësuar vendos lirishëm për antarësimin në organizatë sindikale.
2. Askush nuk duhet të jetë i diskriminuar, apo ti cenohen të drejtat e të punësuarit për shkak të anëtarësimit, mosanëtarësimit në organizatë sindikale, për aktivitet sindikal në organizatën sindikale.
3. Autoritetet qeveritare, nuk mund të ndërhyjnë në kufizimin e të drejtave dhe lirive sindikale ndaj të punësuarve apo të pengojnë ushtrimin e lirshëm të aktiviteteve në sindikata.

Neni 5

Organizatat me veprimtari të dryshme

1. Organizatat sindikale mund të themelohen sipas veprimtarive të njëjta, ose sipas veprimtarive të ndryshme në të cilat ndërlidhen interesat e të punësuarëve;
2. Organizatat sindikale me veprimtari të njëjtë dhe me veprimtari të ndryshme kanë të drejtë të bashkohen dhe të bashkëpunojnë me organizatat sindikale ndërkombëtare, të themeluara për interesat dhe të drejtat e përbashkëta të të punësuarëve.

Neni 6

Themelimi i organizatave sindikale

1. Të punësuarëve i'u garantohet liria e organizimit dhe veprimit sindikal.

2. Sindikatat themelohen për mbrojtjen e të drejtave të të punësuarëve dhe lirive sindikale.
3. Të punësuarit kanë të drejtë në bazë të vullnetit të lirë, të themelojnë sindikatën dhe të anëtarësohen në të, sipas kushteve të cilat janë të përcaktuara me këtë ligj dhe statut .
4. Organizatat sindikale kanë të drejtë, që aktivitetin e tyre ta realizojnë në pajtim me aktet normative, të zgjedhin vullnetarisht përfaqësuesit e tyre, të organizojnë administratën, të zhvillojnë aktivitetet sindikale dhe të hartojnë programe sindikale.

Neni 7

Krijimi i kushteve për veprim sindikal nga punëdhësi

1. Punëdhënësi duhet të krijojë kushte dhe lehtësira të nevojshme për përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave sindikale, për veprim sindikal të të punësuarëve;
2. Për krijimin e kushteve të volitshme për veprim sindikal, punëdhënësi duhet të angazhohet në:
 - 2.1. lejimin e qarkullimit në mjediset e ambientit të punës;
 - 2.2. lejimin e shpërndarjes së njoftimeve, broshurave, publikimeve dhe dokumenteve të tjera të organizatës sindikale për aktivitete sindikale;
 - 2.3. ligurimin e kohës së nevojshme për aktivitet sindikal brenda dhe jashtë vendit;
 - 2.4. krijimin dhe ofrimin e lehtësirave për grumbullimin e mjeteve të kuotizimit si; dhe
 - 2.5. krijimin e kushteve optimale për funksionimin e sindikatës, duke përfshirë organizimin e mbledhjeve dhe takimeve të ndryshme sindikale.

Neni 8

Qëllimi i themelimit të sindikatës

1. Qëllimi kryesor i themelimit të sindikatave është:
 - 1.1. krijimi i kushteve dhe standardeve më të mira të punës së të punësuarve;
 - 1.2. mbrojtja e të drejtave ligjore, ekonomike, sociale, profesionale, për të punësuarit;
 - 1.3. avancimi dhe zhvillimi i dialogimit social mes partnerëve social.

2. Me qëllim të realizimit të interesave të njëjta si dhe fuqizimit të sindikatës për avancimin dhe zhvillimin e dialogut social me partnerët social, sindikatat mund të organizohen në vijën vertikale në Shoqata, Federata dhe Konfederata Sindikale.

Neni 9 **Anëtarësimi në sindikatë**

1. Anëtar i sindikatës mund të jetë çdo i punësuar që sipas ligjit në fuqi ka plotësuar moshën e punësimit, përveçë punëdhënsit.
2. Anëtarësimi në sindikatë bëhet sipas vullnetit të lirë të të punësuarit.
3. Gjatë aplikimit për anëtarësim duhet të jepet deklarata me shkrim, si dhe të plotësohet formulari i cili duhet të ketë emrin dhe mbiemrin, gjininë, ditëlindjen, vendbanimin, adresën, profesionin, vendin e punës dhe nënshkrimin e anëtarit.
4. Anëtarit të sindikatës i jepet kartela e anëtarësisë, si dëshmi për anëtarësim.
5. Anëtar i sindikatës është i obliguar të paguajë rregullisht anëtarësinë mujore sindikale, në shumën të cilën e cakton organi kompetent i sindikatës.
6. Anëtar i një sindikate, nuk mund të jetë njëkohësisht edhe anëtar i sindikate tjetër.
7. Me nënshkrimin personal të deklaratës për anëtarësim nga të punësuarit, krijohen raporte të të drejtave dhe detyrimeve për anëtarin e sindikatës sipas Statutit.

Neni 10 **Zgjedhjet në sindikatë**

1. Të gjithë anëtarët e sindikatës kanë të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur.
2. Të drejtën për tu zgjedhur nuk do ta gëzojnë anëtarët të cilët:
 - 2.1. kanë pozita menaxheriale;
 - 2.2. janë të zgjedhur dhe të emëruar në organet e pushtetit lokal dhe qendror;
 - 2.3. janë të zgjedhur në strukturat udhëheqëse të partive politike.
3. Anëtarët e zgjedhur mund të japin dorëheqje apo të shkarkohen nga detyra nga organi i cili i ka zgjedhur në pajtim me dispozitat ligjore.

Neni 11

Pushimi i anëtarësisë sindikale

1. Anëtarit të sindikatës do t'i pushojë anëtarësia sipas Ligjit dhe Statutit Sindikal në këto raste:
 - 1.1. kur anëtari largohet nga organizata sindikale me vullnet të shprehur me deklaratë me shkrim;
 - 1.2. kur anëtari vepron në kundërshtim me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera sindikale;
 - 1.3. kur anëtari nuk e paguan anëtarësinë tre (3) muaj me radhë;
 - 1.4. në rastin e pensionimit të të punësuarit;
 - 1.5. kur anëtari vdes.
2. Shoqata sindikale e cila nuk i kryen detyrimet e kuotizimit apo detyrimet e tjera ligjore dhe statutare brenda periudhës tre (3) mujore, përjashtohet nga Federata Sindikale;
3. Federata Sindikale e cila nuk i kryen detyrimet e kuotizimit apo detyrimet e tjera ligjore dhe statutare brenda periudhës tre (3) mujore, përjashtohet nga Konfederata Sindikale;
4. Të dhënat nga paragrafi 2. dhe 3. të këtij neni, do t'i konstatojë shërbimi kompetent financiar i Federatës, përkatësisht Konfederatës Sindikale.

Neni 12

Kushtet dhe kriteret për regjistrimin e sindikatave

1. Organizatat e punëtorëve (Shoqata, Federata dhe Konfederata Sindikale) për zyrtarizimin e fushveprimit të tyre, duhet të aplikojnë për regjistrim në organin përgjegjës të Ministrisë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale.
2. Shoqata Sindikale, si njësi themelore organizative, mund të regjistrohet në MPMS, nëse ka së paku dhjetë (10) anëtarë sindikal.
3. Federata Sindikale, mund të regjistrohet në MPMS-ë, nëse në kuadër të saj ka së paku dy (2) shoqata sindikale të veprimtarive të njëjta ose të ngjashme anëtarësia e të cilave është së paku 10% e të punësuarve në nivel të sektorit përkatës.
4. Konfederata Sindikale, mund të regjistrohet në MPMS-ë, nëse në kuadër të saj veprojnë së paku dy (2) Federata Sindikale të veprimtarive të ndryshme, anëtarësia e të cilave është së paku 10% e të punësuarve në nivel të vendit.

5. Sindikatat mund ta fillojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e vet, vetëm pasi të jenë regjistruar në MPMS-ë.

Neni 13 **Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim**

1. Sindikata në cilësinë e Shoqatës, Federatës apo të Konfederatës me rastin e aplikimit për t'u regjistruar në MPMS-ë, krahas kërkesës me shkrim duhet të prezentojë edhe këtë dokumentacion:

- 1.1. statutin e Sindikatës (Shoqatës, Federatës apo të Konfederatës);
- 1.2. procesverbalin e mbledhjes konstitutive të sindikatës;
- 1.3. dokumentin për emërtimin, selinë, dhe llogon e sindikatës;
- 1.4. regjistrin e anëtarëve sindikal, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, numrin e letërnjoftimit, nënshkrimet dhe adresat e anëtarëve sindikal;
- 1.5. deklaratat për anëtarësim të anëtarëve sindikal në sindikatë;
- 1.6. të dhënat e sakta për udhëheqjen sindikale, duke përfshirë emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, numrin e letërnjoftimit, telefonit dhe nënshkrimet e anëtarëve të udhëheqësisë sindikale;
- 1.7. emërtimin e sindikatës i cili nuk duhet të jetë i njëjtë me sindikatat e regjistruara në MPMS-ë;
- 1.8. ministria në raste të veçanta për verifikim, mund të kërkojë verifikimin e deklaratave të anëtarëve sindikal.

Neni 14 **Procedurat e regjistrimit**

1. Kërkesa për regjistrimin e sindikatës së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, parashtrohet në organin përgjegjës për regjistrimin e sindikatave në MPMS-ë.

2. Organi përgjegjës i MPMS-së, nëse vlerëson se janë përmbushur kushtet dhe kriteret për regjistrim të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitat e tjera pozitive, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e aplikimit për regjistrim, nxjerr vendim në formë të shkruar, për regjistrimin e sindikatës.

3. Organi përgjegjës i MPMS-së, kur vlerëson se ka mangësi në dokumentacion, kërkon nga përfaqësuesi i organizatës sindikale në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të

kërkesës, të ofrojë dokumentacion shtesë me qëllim që të përmbushen kushtet dhe kriteret për regjistrim, të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitat e tjera ligjore.

4. Në rastet kur sindikata nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara për regjistrim, të përcaktuara me ligj, organi përgjegjës i MPMS-së nxjerr vendim për refuzimin e regjistrimit të sindikatës, duke informuar aplikuesin për arsyet e refuzimit.

5. Kundër vendimit të MPMS-së, pala e pakënaqur, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, mund të ushtrojë padi për fillimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente, nga dita e pranimi të vendimit.

6. Ministria do të publikojë në Gazetën Zyrtare, listën e sindikatave të regjistruara.

Neni 15 **E drejta e sindikatës pas regjistrimit**

1. Pas regjistrimit, sindikata ka të drejtë:

1.1. t'i gëzojë të gjitha të drejtat e një personi juridik, në pajtim me dispozitat ligjore;

1.2. t'i përfaqësojë anëtarët e vet para punëdhënësve dhe autoriteteve publike në lidhje me çdo çështje që përfshin negociatat kolektive për të punësuarit, veçmas në avancimin e dialogut social, të drejtave ekonomike e sociale, nga marrëdhënia e punës;

1.3. t'i administrojë mjetet e saj për mbrojtjen e të drejtave të të punësuarëve.

Neni 16 **Legjitimiteti sindikal**

1. Sindikata e regjistruar do të ketë cilësinë e personit juridik, me të drejtat dhe detyrat e caktuara me ligj, Statutin e Sindikatës dhe Konventat Ndërkombëtare të ONP-së.

2. Sindikata duhet të këtë llogon e saj e cila do të jetë e graviruar në vulë dhe është e ndaluar të përdoret nga sindikatat e tjera.

3. Sindikatën e përfaqëson kryetari i Sindikatës.

4. Sindikata duhet të këtë konton bankare me autorizim, për financimin e veprimtarisë sindikale.

Neni 17

E drejta e përfaqësimit

1. E drejta e përfaqësimit sindikal përcaktohet sipas këtyre kritereve :

1.1. regjistrimi i sindikatës në organin kompetent të MPMS.

1.2. numrit të anëtarëve të regjistruar me fletëdeklaratat për anëtarësim dhe fletëpagesës së anëtarësimit.

2. Sindikata do të fitojë të drejtën e përfaqësimit në lidhje të kontratave kolektive , lidhje të marrëveshjeve me punëdhënësit, në kuadër të organit të dialogut social, në rast se ka së paku 10% të anëtarëve, nga totali i të punësuarve në nivel të ndërmarrjes, sektorit dhe nivel vendi.

Neni 18

Organet e sindikatës

1. Sindikatat zgjedhin dhe formojnë organet e veta në pajtim me Statutin dhe aktet e tjera sindikale.

2. Organet e sindikatës kryejnë veprimtarinë e tyre sipas Ligjit, Statutit, Konventave Ndërkombëtare dhe parimeve ndërkombëtare sindikale të KNS-së dhe KSE-së

Neni 19

Rregullimi i fushëveprimit sindikal

Organizatat sindikale, fushëveprimin e vet e rregullojnë me Statut dhe akte të tjera të brendshme, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 20

Dialogu Social

1. Partner social i punëdhënësit është Sindikata përfaqësuese.

2. Sindikata përfaqësuese e nivelit përkatës në cilësinë e partnerit social negocion dhe nënshkruan Kontratat Kolektive të nivelit përkatës.

3. Sindikatat jo përfaqësuese, mund të kontribuojnë në proesin e dialogimit social përmes rekomandimeve, opinioneve ose tryezave publike.

Neni 21

Burimet financiare të sindikatës

1. Mjetet financiare për fushëveprimin sindikal sigurohen nga:
 - 1.1. kuotizacioni i anëtarësisë,
 - 1.2. donacionet e ndryshme,
 - 1.3. ndihmat solidare,
 - 1.4. të hyrat nga prona sindikale, dhe
 - 1.5. burimet e tjera që nuk janë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe statutare.
2. Punëdhënësi obligohet që të sigurojë inkasimin e kuotizimit të anëtarësisë në mënyrë institucionale, ku mjetet nga kuota e anëtarësisë do të derdhen në xhirollogarinë e sindikatës përkatëse.
3. Organizimet sindikale në nivel të Federatës dhe Konfederatës janë të obliguara që në fund të çdo viti fiskal, të bëjnë një auditim të jashtëm të mjeteve të shpenzuara.
4. Mjetet financiare të anëtarësisë sindikale barten dhe shpenzohen në formën institucionale në pajtim me vendimin e organit kompetent të Shoqatës Sindikale, Federatës, përkatësisht Konfederatës.

Neni 22

Prona e sindikatës

1. Pasuria e sindikatës është unike dhe e patjetërsueshme.
2. Sindikata ka të drejtën e identifikimit të pasurisë dhe pronës.
3. Organizatat sindikale kanë të drejtë në prona dhe pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Pronën.

Neni 23

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të sindikatës

Anëtarët e sindikatës duhet të marrin pjesë në punën dhe aktivitetet e sindikatës, t'u përmbahen parimeve dhe normave të statutit, të ruajnë imazhin dhe unitetin e sindikatës si dhe të paguajnë kuotën mujore të anëtarësisë sindikale.

Neni 24

Imuniteti i përfaqësuesve sindikal

1. Ndalohet diskriminimi ndaj përfaqësuesve të organizatave sindikale.
2. Për aktivitete sindikale, përfaqësuesit sindikal, pa pëlqimin e sindikatës nuk mund t'i:
 - 2.1. ndërpritet kontrata e punës;
 - 2.2. caktohet vend tjetër i punës;
 - 2.3. ulet pozita e vendit të punës;
 - 2.4. fillojë procedura disiplinore;
 - 2.5. zvogëlohet paga.
3. Të zgjedhurit e lartë sindikal, kryetari dhe nënkryetarët e Federatës dhe Konfederatës sindikale, pas skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur, e kanë të drejtën e rikthimit në vendet e punës në përputhje me përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës.
4. Të drejtat e përcaktuara me paragrafin 2., të këtij neni, do të jenë të zbatueshme në afat prej dy (2) viteve, pas përfundimit të mandatit të rregullt të përfaqësuesit sindikal.

Neni 25

Ndalimi i ndërhyrjes

1. Ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin e programeve sindikale, në zgjedhjen e përfaqësuesve sindikal, dhe në administrimin e organizatave sindikale nga autoritet qeveritare.
2. Ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave sindikale nga punëdhënësit ose organizatat e punëdhënësve.
3. Organizatat sindikale mund t'i drejtohen gjykatës për veprime ndërhyrëse ose kërcënim ndaj tyre.
4. Veprime ndërhyrëse konsiderohen:
 - 4.1. aktet që pengojnë krijimin, funksionimin ose administrimin e një organizate sindikale;
 - 4.2. aktet që dëmtojnë organizatën sindikale për shkak të përkatësisë ose veprimtarisë sindikale duke e diskriminuar;

4.3. aktet që nxisin krijimin e organizatave sindikale nga punëdhënës ose organizata punëdhënësish, me qëllim të vendosjes së kontrollit të tyre.

Neni 26

E drejta për organizimin e Federatave dhe Konfederatave

1. Organizatat sindikale kanë të drejtë të krijojnë Federata dhe Konfederata Sindikale, si dhe të drejtën për t'u anëtarësuar në to.
2. Federatat apo Konfederatat Sindikale vendore kanë të drejtë të anëtarësohen në konfederata ndërkombëtare sindikale.

Neni 27

Presioni sindikal dhe e drejta në grevë

1. Për realizimin e kërkesave sindikale lejohen format e presionit sindikal, si protestat dhe grevat e punëtorëve në pajtim me Konventat Ndërkombëtare, ligjet e aplikueshme dhe Statutin sindikal.
2. E drejta në grevë është një e drejtë elementare e të punësuarve dhe organizmave sindikalë e cila në Kosovë garantohet me Ligjin për Grevë.
3. Gjatë organizimit të formave të presionit sindikal, ndalohet përdorimi i dhunës nga ana e të punësuarve.
4. Ndalohet përdorimi i dhunës dhe marrja e masave ndëshkuese nga punëdhënësit, ndaj të punësuarve që kanë marrë pjesë në një protestë dhe grevë sindikale të ligjshme.

Neni 28

Kontestet sindikale

1. Kontestet e ndryshme sindikale në mes të Federatës dhe Konfederatës, zgjidhen nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve, në kuadër të Konfederatës Sindikale, në bazë të parashtrimit të kërkesës nga palët e interesuara.
2. Palët e pakënaqura mund të kërkojnë inicimin e procedurës, pranë organit më të lartë të Konfederatës i cili merr vendim përfundimtar.

Neni 29
Zgjidhja e kontesteve sindikale

1. Zgjidhjen e kontesteve eventuale në nivele të ndryshme të organizatave sindikale e bënë Komisioni i përbërë prej pesë (5) anëtarësh. Komisioni zgjidhet nga organet më të larta sindikale të nivelit përkatës.
2. Komisioni nga radhët e veta zgjedh kryetarin.
3. Gjatë punës, Komisioni mund të angazhojë ekspertë të fushave përkatëse, me qëllim të zgjidhjes së drejtë të kontestit.
4. Organet e Federatave Sindikale janë të obliguara që t'i japin ndihmë, Komisionit në formën që ai e kërkon.
5. Komisioni vendos me shumicën e votave të anëtarëve të zgjedhur dhe punon në bazë të këtij ligji, Statutit Rregullores të Punës që ai e harton dhe miraton.

Neni 30
Mbrojtja e anëtarëve sindikal në Gjykatë

Çdo organizatë sindikale e njohur si person juridik, mund t'i drejtohet Gjykatës për mbrojtjen e interesave të secilit prej anëtarëve të saj, për të obliguar punëdhënësin që të veprojë sipas dispozitave të ligjit në fuqi.

Neni 31
Dispozitat ndëshkimore

1. Personi fizik, që nuk i përfill dispozitat e këtij ligji, në procedurë ligjore, do të dënohet me të holla prej dyqind (200) deri njëmijë (1000) Euro.
2. Personi juridik, ose personi përgjegjës i personit juridik që nuk i përfill dispozitat e këtij ligji, në procedurë ligjore, do të dënohet me të holla prej pesëqind (500) deri tremijë (3000) Euro.
3. Mjetet e grumbulluara nga gjobat e shqiptuara, barten në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 32
Zbatimi i ligjit

1. Ministri i MPMS-së do të nxjerrë akte nënligjore, për të siguruar implementimin e plotë të dispozitave të këtij ligji, jo më vonë se gjashtë (6) muaj, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji e bën Inspektorati i punës.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-011
28 korrik 2011

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI